



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10¹ dhe 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me propozimin PA1 nr.08-104 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-104 datë 17.3.2023 dhe sipas Konkluzionit, ark.nr.02-1188/14 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, nr.08-65 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzionin ark.nr.02-1007/13 datë 8.3.2023, miratoi Propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-104 datë 7.3.2023 dhe inicioi procedure për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, nr.08-65 datë 5.1.2015, për faktin se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-997/1 datë 3.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin (tarifën) vjetore për leje për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia më datë 9.3.2023, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-104 datë 9.3.2023, për njoftim se nëse nuk paguan tarifën vjetore për leje për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 17.3.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikë, është dorëzua Njoftim ark.nr.05-997/2 datë 17.3.2023 që Shoqëria Tregtare Radiodifuzive më METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, më 27.2.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 90.000,00 (nëntëdhjetë mijë) denarë, më 28.2.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 110.000,00 (njëqind e dhjetë mijë) denarë më 3.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 43.654,00 (dyzet e tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë) denarë, më 6.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 57.000,00 (pesëdhjetë e shtatë mijë) denarë, më 7.3.2023 ka kryer

Уп1 Бр.08-104

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

pagesë në shumë prej 30.000,00 (tridhjetë mijë) denarë, më 9.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 41.000,00 (dyzet e një mijë) denarë, më 13.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 17.000,00 (shtatëmbëdhjetë mijë) denarë dhe më 16.3.2023 ka kryer pagesë prej 38.000,00 (tridhjetë e tetë mijë) denarë, me të cilën transmetuesi e ka paguar plotësisht tarifën vjetore.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10 dhe 13 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-104 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-104 datë 17.3.2023, sipas Konkluzionit ark.nr.02-1188/14 datë 21.03.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi ndërprerjen e procedrës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Пkundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita epranimi të vendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).